

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dosja e “Grupit të intelektualëve”: nëntë të dyshuar për vrasjen dhe zhdukjen e civilëve
ADRESA	https://albeu.com/kosove/dosja-e-grupit-te-intelektualeve-nente-te-dyshuar-per-vrasjen-dhe-zhdukjen-e-civileve/1031246/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 15:24:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 15:22:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e7f50c6ba0a77698a53cce4da40149dc24e387ea96b5918155e67d328da30202
TEKSTI	e7fd102e8c54a39fb60786d4991a13d38f0606ab030b389dd58c5cb72452dc13
PAMJA	06b1c8b214f5bca55833a898bf530ce8cbad281b0688493bd28f4186329702d2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4bc50c6ba0a77698a53cce4da40149dc24e387ea96b5918155e67d328da30202
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	70759019bbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon një rën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4bc50c6ba0a77698a53cce4da40149dc24e387ea96b5918155e67d328da30202>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dosja e “Grupit të intelektualëve”: nëntë të dyshuar për vrasjen dhe zhdukjen e civilëve



Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Special, caktimin e paraburgimit për nëntë persona të dyshuar për “Krime lufte kundër popullsisë civile”.

Sipas kërkesës së PSRK-së, të siguruar nga “Betimi për Drejtësi”, të dyshuarit janë Dragan Gjuriq, Millosh Rasković, Miroslav Radojeviq, Radisav Rasković, Sasha Gjuriq, Svetislav Gjuriq, Vukoje Lepović, Rangel Rasković, i njohur me nofkën “Lane”, dhe Dalibor Gjuriq.

Prokuroria i lidh ata me rastin e “Grupit të intelektualëve” dhe dyshon për përfshirje në vrasjen e zhdukjen e 23 civilëve në Zubin-Potok. Sipas dosjes, civilët u ndaluan, u plaçkitën dhe u keqtrajtuat para se të ekzekutoheshin. Më pas, të dyshuarit tentuan t’i digjinin trupat me benzinë dhe i masakruan me mjete të forta, raporton “Betimi për Drejtësi”.

Në dokument përshkruhet se, më 19 prill 1999, gjatë luftës në Kosovë, Dragan Gjuriq, Milomir Radojeviq, Millosh Rasković, Miroslav Radojeviq, Radisav Rasković, Sasha Gjuriq, Svetislav Gjuriq, Vladan Tomaseviq, Vukoje Lepović, Rangel Rasković, i thirrur “Lane”, Jovica Utviq dhe Dalibor Gjuriq, së bashku me persona të tjerë të njohur për Prokurorinë, ishin pjesëtarë të Mbrojtjes territoriale ushtarake. Të mobilizuar dhe të armatosur me armë të ndryshme, ata ishin angazhuar në fshatrat e Zubin-Potokut. Në vendin e quajtur Melaja, në Kalludër të Vogël, ata ndaluan 23 civilë shqiptarë, të cilët fillimisht i plaçkitën e i maltretuan dhe më pas i vranë.

Viktimat e vrara në atë vend janë Adem Ademi, Demir Ahmeti, Idriz Rreci, Adem Beqiri, Hasan Dervari, Sahit Barani, Fatmir Fazliu, Ali Haliti, Bekim, Naser, Sali, Samir, Selim, Shaqir, Tahir, Gjemajl, Gjevdet dhe Zymer Meziu, si dhe Faton, Mahit, Nazmi, Shaip dhe Shkelzen Ujkani.

Kërkesa e Prokurorisë bën të ditur se 20 prej viktimave vazhdojnë të jenë të zhdukur, ndërsa tre janë identifikuar përmes analizave të ADN-së.

të fundit /



Dosja e “Grupit të intelektualëve”: nëntë të dyshuar për vrasjen...




Amber: Nëse do të kisha diçka me një banor të “Big Brother...”



I akuzuar për krime të lidhura me gjenocidin në Ruandë, Brown...



Pas incidentit në Fairford, pista iraniane shihet si më e...



Holandë: Eutanazia për një fëmijë dyvjeçar, rasti i parë i raportuar...



Macroni, nga Metzi: Europa të mos i nënshtrohet...



Fluturimi i 14-të i Starship, SpaceX synon hyrjen e parë n...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Sipas dosjes, të dyshuarit, në bashkëkryerje me persona të tjerë të identifikuar, i varrosën viktimat në fund të një livadhi në Melaja, pranë lumit, në Kalludër të Vogël, me synimin për të fshehur gjurmët e krimit.

Prokuroria pretendon se më 20 prill 1999, rreth orës 10:00, ata u kthyen në të njëjtin vend. Trupat e 13 personave të vrarë u nxorën dhe u tentua të digjeshin me benzinë. Pasi karburanti mbaroi, kufomat u masakruan me sëpata, çekiçë dhe tërnakopë, e më pas u varrosën pranë lumit, rreth 200 metra larg vendit të vrasjes.

Dosja përmend edhe vrasjen me armë zjarri, më 18 prill 1999, të Sahit dhe Sadete Fekës, Deli Isufit dhe Rabije Isufit.

Pas vrasjes, të pandehurit dhe persona të tjerë të identifikuar i varrosën viktimat në fshatin Jabukë të Zubin-Potokut. Dëshmitarin dhe të dëmtuarin Muharrem Feka e ndanë nga grupi, e sulmuan fizikisht dhe më pas e urdhëruan të vendoste duart pas kokës e të vazhdonte drejt malit. Sipas dosjes, ata qëlluan në drejtim të tij dhe e plagosën në kokë e kraharor.

Feka u rrëzua dhe humbi vetëdijen, por dëgjoji të shtënat. Kur u përmend, familjarët dhe policia nuk ndodheshin më në vendin e ngjarjes. Në gjendje të rëndë, ai vazhdoi nëpër male deri në fshatin Germovë, ku ndihmën e parë ia dha një fqinje, e cila ishte teknike medicinale.

Shtuar më 28.09.2026 17:22

Tags: [Policia e Kosovës](#), [Zbulohet dosja](#)



Përparim Rama pas deklaratës për aktgjykimin e Speciales: Kosova u...



Kërkohet paraburgimi për 9 të dyshuarit për masakrën e 23 civilëve në Zubin-...



Ushtarët britanikë të forcës rezervë strategjike të KFOR-it vendosen në...



Vigan Qorolli merr drejtimin e Komisionit për Legjislacion



Ambasada amerikane vlerëson bashkëpunimin me Kosovën pas...



Mihali: Kanë mbetur shtatë ditë për zgjedhjen e Presidentit, më pas mund...



Partitë parlamentare ende pa dakordësi për presidentin, ndërsa afati...



Altin Krasniqi: Mbrojtja e UÇK-së kërkon hapa konkretë



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.